

VENDIM
Nr.1305, datë 24.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.771, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË BURREL, TË QARKUT TË DIBRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.771, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Përmasat e pronave me nr.54 e nr.55 zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Shtohen pronat me nr.55/1, nr.483 e nr.484, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronat me nr.483 e nr.484 t'i transferohen, në pronësi, bashkisë Burrel, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Burrelit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia: Burrel										
Fusha e përdorimit të pronës: zhvillim, ekonomi, industri-tregti-shërbim										
Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip.totale e pronës (m ²)	Nga sip.totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrimi	Inst.enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
54	1326 Bu-G-3	5/128	Truall+ ndërtesë	Nd.përpunim drurit L.Partizani	1497	245	Zyrë	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Ekonomisë	
55	1326 Bu-G-3	5/132 5/130 5/133	Truall+ ndërtesë	Ish-zdruktaria	4175	2937	Pa funksion	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Ekonomisë	
55/1	1326 Bu-G-3	5/131	Truall	Rrethimi i nd.përpunim drurit e zdruktarisë	3886	0	Pa funksion	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Ekonomisë	
483	1326 Bu-G-4	5/106	Truall+ ndërtesë	Tregu industrial	1646	1028	Tregu i mirë art.industr.	Bashkia Burrel	Bashkia Burrel	
484	1326 Bu-E-4	3/28	Ndërtesë	Banjat publike	63	63	WC	Bashkia Burrel	Bashkia Burrel	